



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PML.nr.425/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Mejreme Memaj e Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlina Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit F. G., nga F., rruga “V. G.”, nr..., për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor, parashikuar me nenin 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, avokatit Urim Bajraktari, paraqitur kundër aktgjyimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, nr.2023:130868 datë 4 dhjetor 2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16 korrik 2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesat e mbrojtësit të dënuarit F. G. për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjyimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, nr.2023:130868 datë 4 dhjetor 2023.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin nr.2023:130868 datë 4 dhjetor 2023, të pandehurin F. G. e ka shpall fajtor për veprat penale lëndimi i lehtë trupor, parashikuar me nenin 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK, dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 366 par.1 të KPRK, dhe pasi që ia ka caktuar dënimin me burgim për secilën vepër veç e veç dhe atë për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor dënimin me burgim në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë

(15) muajve, kurse për veprën e dytë dënimit me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muajve, konform dispozitës së nenit 76 të KPRK e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej njëzet e katër (24) muajve, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 9 qershor 2023 deri me 4 dhjetor 2023.

Në procedurën ankimore sipas ankesës së përfaqësuesit të të dëmtuarit dhe mbrojtësit të pandehurit, aktgjykimi i lartcekur është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.111/2024 datë 22 maj 2024.

Kundër aktgjykimeve të lartcekura kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit avokati Urim Bajraktari, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj kërkesën si të bazuar, aktgjykimet e kundërshtuara t'i ndryshojë ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptohet dënim i kushtëzuar, apo dënimi me burgim ti zëvendësohet me gjobë apo ndaj tij të shqiptohet një dënim me i butë nga ai që i është shqiptuar e me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit.

Prokurori i Shtetit, me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.241/2024 datë 12 korrik, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat të çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

- kërkesat nuk është e bazuar.

Mbrojtësi në kërkesë pretendon se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira me shkelje të ligjit penal, ngase bien ndesh me dispozitat e kodit penal, konkretisht nenit 71 e 72 par.1 nënpar.1.6 të KPRK ku në mënyrë shprehimore është përcaktuar se “nëse për veprën penale është paraparë si masë me ultë dënimi me burgim me më pak se një (1) vit, dënimi mund të zbutet deri në tridhjetë (30) ditë burgim”. Në rastin konkret sipas mbrojtjes gjykatat nuk i kanë trajtuar me kujdes rrethanat lehtësuese dhe atë kontributin e të dëmtuarit, gjendjen emocionale të të pandehurit në momentin e kryerjes së veprës penale lëndim i lehtë trupor, si dhe të gjitha rrethanat tjera lehtësuese për të cilat gjykata penale ka për obligim që të kujdeset çdoherë sipas detyrës zyrtare. Pastaj, i pandehuri që nga fillimi i procedurës penale ka shprehur gatishmëri që të bashkëpunojë me organet e drejtësisë, sa i përket veprës penale të armëmbajtjes pa leje e ka pranuar fajësinë, kurse për veprën penale të parë nuk është pajtuar me cilësimin ligjor. Në kuadër të këtyre rrethanave gjykata ka mundur ndaj të pandehurit të caktojë dënim të kushtëzuar, meqë plotësohen të gjitha kushtet nga neni 49 i KPRK duke pasur parasysh edhe faktin se i pandehuri është kryefamiljar, mbajtës i familjes dhe në rast se do të shkonte në vuajtje të dënimit do të rrezikohej ekzistenca e familjes. Pastaj, sipas mbrojtësit pjesa dërmuese e vendimeve gjyqësore sa i përket këtyre veprave penale janë dënim me gjobë, me kusht apo dënime shumë me të buta se dënimi i shqiptuar ndaj të dënuarit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme nuk janë të bazuara. Vlen të theksohet se mbrojtësi me kërkesë aktgjykimit i kundërshton për shkelje të ligjit penal, por, nga përmbajtja e kërkesës del se e kundërshto vendimin për dënim. Konform dispozitës së nenit 432 të KPP ndaj vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet në rast të shkeljes së ligjit penal, në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 i këtij kodi ose në rast të shkeljeve tjera të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Pra, bazuar në këtë dispozitë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të vendimit për dënim.

Vendimi mbi dënimin mund të kundërshtohet me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në kuadër të shkeljes së ligjit penal vetëm në rast se gjykatat me rastin e marrjes së vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale kanë tejkaluar kompetencat ligjore e që paraqet shkelje të ligjit penal (neni 385 par.1 nënpar.1.5 i KPP). Gjykata i tejkalon kompetencat ligjore kur shqipton dënimin i cili nuk mund të shqiptohet nën minimumin e veçantë ose mbi maksimumin apo shqipton lloj tjetër të dënimit i cili nuk mund të shqiptohet për atë vepër penale. Në rastin konkret gjykata nuk i ka tejkaluar autorizimet e veta ligjore, ngase për veprat penale për të cilat është shpall fajtor i dënuari, i janë shqiptuar dënime në kuadër të minimumit dhe maksimumit të paraparë ligjorë.

Është fakt se sipas dispozitës së nenit 72 par.1 nënpar.1.6 të KPRK në rastet kur për veprën penale është paraparë si masë me e ulët dënimi me burgim me më pak se një vit, dënimi mund të zbutet deri në tridhjetë (30) ditë burgim, por kjo nuk nënkupton se gjykata duhet ta zbusë dënimin nën minimumin e paraparë ligjor, ngase është në diskrecion të gjykatës që ta zbusë dënimin brenda kufijve të paraparë me dispozitën e lartcekur. Kurse, a është adekuat apo në proporcion me peshën e veprës penale dënimi i shqiptuar në kuadër të kësaj dispozite ligjore nga gjykata e shkallës së parë është çështje që mund të kundërshtohet me ankesë në gjykatën e shkallës së dytë dhe gjykata e shkallës së dytë ka diskrecion që ta ndryshoj vendimin në këtë drejtim, por vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë sa i përket caktimit të dënimit - llojit dhe lartësisë së dënimit nuk mund të kundërshtohet me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, prandaj pretendimet në këtë drejtim kjo gjykatë i konsideron si të pabazuara.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

PML.nr.425/2024, më 16 korrik 2024

Procesmbajtësja,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetari i kolegjit  
Afrim Shala